



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KGJK.nr.514/2022
Datë: 27 dhjetor 2022

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 6 të Rregullores nr. 04/2021 për Procedurën e Rekrutimit dhe Përzgjedhjes së Bashkëpunëtorëve Profesional, në mbledhjen 301-të, të mbajtur me datë 27 dhjetor 2022, merr këtë:

V E N D I M

- I. Themelohet Komisioni për Rishqyrtim të ankesave të kandidatëve për bashkëpunëtor profesional në gjykatat e Republikës së Kosovës, në përbërjen si në vijim:
 1. Ragip Namani, gjyqtar në Gjykatën Supreme/kryetar i komisionit;
 2. Gani Avdiu, gjyqtar në Gjykatën e Apelit/anëtar i komisionit;
 3. Bujar Dobërdolani, gjyqtar në Gjykatën Themelore Prishtinë/anëtar i komisionit;
 4. Suzana Çerkini, gjyqtare në Gjykatën Themelore Prishtinë/anëtare rezervë;
 5. Snezana Mihajlovic, gjyqtare në Gjykatën Themelore Gjilan/anëtare rezervë.
- II. Vendimi hyn në fuqi me datë 27 dhjetor 2022.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me vendimin KGJK.nr.512/2022, ka shpallur konkurs për bashkëpunëtor profesional në gjykatat e Republikës së Kosovës, si dhe ka themeluar Komisionin për Rekrutim.

Me qëllim të mbarëvajtjes së këtij procesi në rast të ankesave eventuale të kandidatëve për bashkëpunëtor profesional ndaj vendimeve të Komisionit për Rekrutim, në këtë takim ka themeluar edhe komisionin për rishqyrtim, konform nenit 6 të Rregullores nr. 04/2021 për Procedurën e Rekrutimit dhe Përzgjedhjes së Bashkëpunëtorëve Profesional, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albert ZOGAJ,
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit;
- Sekretariatit të KGJK-së, si dhe
- Arkivit.